



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**  
**14 Nr. 445/21**  
**Dt. 04.08.2021**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ **Joni Travell** “sh.p.k. me seli në Skenderaj, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. **07.07.2021**, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën **04.08.2021** bie këtë:

**V E N D I M**

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : “ **Joni Travell** “ me seli në Skenderaj, e datës **12.07.2021**, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër vendimit për Dhënie të Kontratës të datës **07.07.2021** lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ **Shërbime të transportit rrugorë të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë vendit** “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: **VU644 – 21 – 1858 – 2-2-1 / Nr. i Brendshëm: 644 – 21 – 026 – 221**
- 2.** Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi ( i ) të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.
- 3.** Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : “ **Shërbime të transportit rrugorë të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë vendit** “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: **VU644 – 21 – 1858 – 2-2-1 / Nr. i Brendshëm: 644 – 21 – 026 – 221**, të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik : **NTSH “ Beka Tours “ me seli në Vushtrri.**

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek. “ **Joni Travell** “ , e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjore, Op. Ek. konsideron se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i përmbushë Kërkesat lidhur me kapacitetin teknik dhe / ose profesional pika 1, 2 dhe 3 për shkak se nuk i përmbushë në tërësi kërkesat e saktësuar në Seksionin II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) si dhe për shkak se çmimet e transportit të pasagjerëve jashtë vendit të vendosuar si në Paramasë/Parallorari, janë llogaritur gabimisht dhe në kundërshtim me Ligjin mbi transportin e pasagjerësve jashtë vendit, pasi që sikurse theksohet në Plotësim Ankesën e O.E. çmimet e dhëna për transport të pasagjerëve jashtë vendit duhen të jenë pa TVSH, duke qenë se ky shërbim është i liruar nga TVSH-ja.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, e veçanërisht çështja e llogaritjes së TVSH-së në çmimet e transportit të pasagjerëve jashtë vendit, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, për arsye se në Paramasë/Parallogarinë e dorëzuar nga O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës **NTSH “ Beka Tours “** në pikën 1 : Shërbimet e transportit rrugorë jashtë

vendit për udhëtarë me autobus dhe minibus, pozicionin nr. 1 : “ Shërbimet e transportit rrugorë jashtë vendit për udhëtarë me autobus “ dhe pozicioni nr. 2 “ Shërbimet e transportit rrugorë jashtë vendit për udhëtarë me minibus “ çmimet janë dhënë me llogaritje të TVSH-së. Bazuar në Ligjin nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, neni 28-Lirimet për aktivitet tjera, paragrafi 4 Transporti rrugor ndërkombëtar i pasagjerëve dhe transporti i mallrave të tyre shoqëruese, siç janë valixhet ose furnizimet e shërbimit që lidhen me transportin e pasagjerëve, pika

4.1. transporti rrugor ndërkombëtar i pasagjerëve nënkupton transportin e pasagjerëve me autobus dhe mjete tjera kur transporti kryhet:

4.1.1. nga një vend në territorin e Kosovës në një vend jashtë territorit të Kosovës, janë liruar nga llogaritja e TVSH-së, rrjedhimit O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës është dashur të veprimi në pajtim me dispozitën ligjore të cituar, dhe të mos llogarisë TVSH-n në çmimet e ofruara tek transporti rrugor jashtë vendit me autobus dhe minibus.

Andaj, për të vlerësuar dhe qartësuar në mënyrë të duhur tenderin e O.E. NTSH „ Beka Tours „ dhe të O.E. tjerë pjesëmarrës të cilët eventualisht kanë llogaritur TVSH-në në çmimet e transportit rrugor jashtë vendit për udhëtarë, me autobus ose minibus, me theks të veçantë pozicionin nën numrin rendorë 1 dhe 2 të pikës A të Paramasë/Parallogarisë dhe, dhe për të plotësuar në tërësi kërkesat lidhur me pranueshmerinë administrative është e domosdoshme që, në pajtim me dispozitat e nenit 28 të Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Interpretimit të KRPP-së në rastet kur një O.E. normën e TVSH-së të përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-në, për një apo më shumë artikuj, në ofertën e tij e vendosë gabimisht pra e vendosë jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-n të nenin 41 pika 41.15 të RUOPP, të rivlerësohet procesi i vlerësimit të tenderëve dhe të nxirret një përfundim i cili do të jetë plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore të cituara si më lartë. Po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-se Autoriteti Kontraktues, bazuar në procesin e rivlerësimit, do të konsideroi një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.

Nga sa u tha më lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa A.K. në procedurën e Ri-vlerësimit do të marrë Vendim meritior lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë

#### **Këshillë juridike:**

**Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrori Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë  
K.R.. nr. 026/2021, datë 04.08.2021

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

**Drejtoria për Prokurim Publik**

  
Amir Haradinaj, ZPP